

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mbështetje për Programin Operacional 2025-2028: Shërbim Mbikëqyrje për projektet: Ndërhyrje për përmirësimin e shtresave asfaltike, Rajoni 1 dhe 2, Rajoni 3 dhe 4 (Faza IV), Ndërhyrje për përmirësimin e aksesit, konektivitetit & mobilitetit rajonal dhe lokal rrugë, Sistemim Asfaltim i rruges Hyrja e qytetit Koplik dhe rruges Dalja e qytetit Koplik per Bajze, Njesia Administrative Koplik, Sistemim asfaltim Bypass Shëngjin, Rikonstruksion i rruges "Qender Konispol -rruga nacionale " (LOTI II), Sistemim asfaltim i rruges "Bajram Curri" segmenti nga km 0+190 m deri ne Intersektimin me rrugen Iliaz kosova km 0+670 m, Rruga hyrëse dhe hapësirave publike në Drilon Tushemisht, Rikualifikimi i rruges ekzistuese qe lidh fundin e rruges Tushemisht – Dogane Loti 1, etj. ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV)- 71247-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 9,561,840 leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor **FSHZH** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithsme sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së perlloritur e fondit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55-43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedure është “Hapur i thjeshtuar”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar,

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në mbështetje të nenin 55, pika 4 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se:

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, 2025** të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika ”b”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar: “Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja b” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: "b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësisve ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në*

atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii.ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.”

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre- viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së perlologaritur te fondit qe prokurohet

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.”

Kriteri është miratuar me qëllim vërtetimin për eksperiencat e ngjashme të operatorit/ëve në fushën objekt prokurimi me qëllim realizimin e objektit të kontratës.. Përvoja e operatorit është element shumë i nevojshëm për autoritetin, për të vërtetuar qendrueshmërinë ekonomike të ofertuesit, eksperiencat dhe besueshmërinë në përmbushjen e sukseshme të kontratës. Në kuptim të nenit 55 të VKM-se vlerësohet vlera e kërkuar në masën 20 % e cila është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës rrjedhimisht nuk sjellë kufizim të pjesëmarrjes në garë të operatorëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për kryerjen e shërbimit objekt kontrate të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në *vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”*. Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me shërbimin e projektimit duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Për mbikqyrjen e punimeve të përgjithshme të ndërtimit Operatori Ekonomik, duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- | | |
|------|------------------------------------------------------------------------------|
| NP 1 | Punime gërmimi në tokë. |
| NP 4 | Drugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale. |
| NP 5 | Punime nëntoksore, ura e vepra arti. |
| NP 7 | Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje. |

- NP 11 Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- NP 12 Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Për mbikqyrjen e punimeve speciale të ndërtimit Operatori Ekonomik duhet të ketë licencat e mëposhtme:

- NS 1 Punime për prishjen e ndërtimeve
- NS 6 Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
- NS 7 Barriera dhe mbrojtje rrugore
- NS 8 Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.
- NS 18 Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te individëve dhe subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit të projektimit të ndërtimit dhe mbikqyrje e kolaudikimit të punimeve miratura me VKM- ne, Nr.759, date 12.11.2014 i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licencat janë të lidhura ngushtësisht me objektin e kontratës për mbikqyrjen e objekteve. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Meqenëse kemi të bëjmë me mbikqyrjen e punimeve në zbatim argumentojmë se Kategoritë e mësipërme janë përcaktuar në përputhje me zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventivin e punimeve të zbatimit.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor për ndjekjen e supervizionit minimalisht. Operatori Ekonomik ose bashkimi i Operatoreve Ekonomike duhet të paraqesin një liste të stafit kryesor të mëposhtem, të cilët duhet të kenë një marrëdhënie kontraktore me operatorin apo partneret në rastin e një bashkimi operatorësh. Për çdo pozicion, operatorët janë të lire të propozojnë me shumë se një kandidat, me qëllim përmbushjen e kriterëve të kërkuara. Pozicionet e stafit kryesor të kërkuar janë si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 4 (Katër)
- Inxhinier Elektrik 2 (dy)

- Inxhinier Hidroteknik 2 (dy)
- Kontrollor Cilesie 2 (dy)
- Kontrollor i volumeve te punes (Quantity Surveyour) 2 (dy)
- Inspektor të sigurimit dhe Shëndetit në punë (HSE) 2 (dy)

Gjithashtu Operatori Ekonomik duhet të propozojë Staf Inxhinierik “Ing. Resident” që do të ndjekë punimet çdo ditë në terren, operatori ekonomik do duhet që në cdo kantier të ketë një Ing. Resident.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti, për secilin prej inxhinierëve të lartpërmendur Operatorët Ekonomike duhet të paraqesin;

- kualifikimet arsimore (diplomat),
- kualifikimet profesionale (licencat profesionale),
- CV.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.10

Në këtë rast, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Per stafin e angazhuar - Marreveshje/kontrate shërbimi apo deklarate nga vete eksperti me nje akt noterial ku te shprehe angazhimin me operatorin fitues kundrejt zbatimit te shërbimit te mbikqyrjes per kete object procurimi (pershkrim per funksionin/rolin qe do te kryeje dhe detyrat perkatese).

Shenim: Për efekt të vlerësimit me pike sipas pikes 4.4 ne Njoftimin e Kontrates, operatorët të ngarkojnë dokumentacionin: CV, certifikata/diploma/kualifikime profesionale si dhe per Drejtues i Ekipit licencen profesionale për mbikëqyrje. Gjithashtu per stafin e propozuar te paraqitet informacioni i kerkuar mbi ekperiencon specifike, sipas percaktimeve te Aneksit nr 1 pjese e ketij DT:

Argumentimi: Referuar në nenin 41 pika 4/b te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.” Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me numrin e objekteve të kontrates së zbatimit dhe vendndodhjen e tyre. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës dhe i bazuar në ligj, me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe mbikëqyrjen e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Personeli teknik i inxhinierëve, kapacitetet dhe aftësitë organizative janë të domosdoshëm gjatë mbikëqyrjes se objekteve. Drejtuesi teknik është përgjegjës për mbikëqyrjen sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe brenda kushteve të kontratës. Në lidhje me inspektorin e sigurimit dhe shëndetit në punë operatori/ët ekonomik/ë gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ku në nenin 1 parashikohet shprehimisht: “Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e

rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit” dhe VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo operator ekonomik, person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Roli i inxhinierëve është përcaktuar dhe në Termat e References.

2.3.4 Operatori ekonomik, duhet të disponojë jo më pak se 14 (katërbëdhjetë) punonjës të siguruar për çdo muaj për periudhën 3 (tre) mujore të fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Për të vërtetuar këtë kusht, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën për periudhën 3 (tre) mujore të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, i cili duhet të përputhet me listë pagesat e punonjësve për këtë periudhë.

Shtojcës nr. 9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.”

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur duke u bazuar në shërbimet e kerkuara sipas Termave të references.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Termat e referencës janë hartuar sipas standardeve dhe nëpërputhje me perckatimet ligjore në fuqi dhe janë pjese e pandare e DST

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) ¹Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

1.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

1. Çmimi	pikët 50
2. Eksperienca e ngjashme e kompanisë	pikët 20
3. Eksperienca e Stafit Teknik të propozuar	piket 30

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Në rastin kur oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të koston, autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë, si dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Formula që zbatohet për llogaritjen e pikëve është si më

poshtë:

$$P_o = P_{k1} + P_{k2} + P_{k3} + \dots$$

P_o - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

$P_{k1}/P_{k2}/P_{k3}/\dots$ - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar, që mund të jetë kriter me trend zbritës ose me trend rritës.

Kriteri:

1. Çmimi **[0-50] pikë**

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

¹ Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë “oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë 20 pikë dhe propozimi teknik 80 pikë.

P_{k1}	Pikët e kriterit që vlerësohet
V_{min1}	Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet
P_{max1}	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k1}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

2. Eksperienca e ngjashme e kompanisë

[0 - 20 pikë]

Ky nën-kriter synon të vlerësojë drejtpërdrejt kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit ekonomik për realizimin e shërbimit, nëpërmjet analizës së eksperiencës së tij në kontrata të ngjashme, të realizuara përtej kërkesave minimale të kualifikimit.

Eksperienca në zbatimin e kontratave të ngjashme në fushën e mbikëqyrjes së punimeve të infrastrukturës rrugore dhe ndërhyrjeve të ngjashme, demonstroi qëndrueshmërinë e operatorit ekonomik në treg, kapacitetin organizativ dhe përvojën e konsoliduar të stafit teknik. Kjo përvojë kontribuon në menaxhimin efektiv të kontratës dhe në minimizimin e risqeve gjatë fazës së zbatimit, duke garantuar cilësinë dhe stabilitetin e shërbimit të mbikëqyrjes.

Operatori ekonomik, për t'u vlerësuar në këtë nën-kriter, duhet të paraqesë kontrata të ngjashme që tejkalojnë kërkesat minimale të përcaktuara në pikën 2.3.1/a, Shtojca 8, dhe që janë realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ofertuesi me vlerën e kontratës së **objektit** të ngjashëm në vlerë absolute më të madhe do ti akordohen pikët maksimale të nën-kriterit dhe ofertuesit e tjerë të kualifikuar (minimalisht sa është përcaktuar në pikën 2.3.1/a), Shtojca 8) do ti akordohen pikët sipas metodologjisë/formulës më poshtë:

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2} = O_{k2} \times P_{max2} / V_{max2}$$

P_{k2}	Pikët e kriterit që vlerësohet
V_{max2}	Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (vlera më e lartë e objektit të ngjashëm)
P_{max2}	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k2}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për të plotësuar këtë kërkesë ofertuesit mjaftojnë të sjellin dokumentacionin e nevojshëm për plotësimin e kriterit të kualifikimit të parashikuar në Shtojcën 8, pika 2.3.1/a. dhe njekohesisht informacion shtese sipas formatit bashkelidhur (Aneksi 2).

3. Eksperienca e Stafit Teknik të propozuar

[0–30 pikë]

- | | |
|--------------------------------------------------------------|-----------------|
| 1. <i>Inxhinier Ndërtimi</i> | <i>pikë 0-5</i> |
| 2. <i>Inxhinier Elektrik</i> | <i>pikë 0-5</i> |
| 3. <i>Inxhinier Hidroteknik</i> | <i>pikë 0-5</i> |
| 4. <i>Kontrollor Cilesie</i> | <i>pikë 0-5</i> |
| 1. <i>Kontrollor i volumeve te punes (Quantity Surveyor)</i> | <i>pikë 0-5</i> |
| 2. <i>Inspektor të sigurimit dhe Shëndetit në punë (HSE)</i> | <i>pikë 0-5</i> |

Ky nenkriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë gjatë zbatimit të punimeve të kontraktorit, duke qenë se aktivitetet/eksperiencat e ngjashme në të cilat ka qenë angazhuar stafi kyc i propozuar nga kompania demonstron aftësinë teknike dhe profesionale të personave që do të angazhohen gjatë zbatimit të shërbimit

të mbikqyrjes, dhe garantojnë AK që me eksperiencën e fituar të tyre kontraktori nuk e ve përpara risqeve të mundshme dhe i jep stabilitet zbatimit të kontratës se punimeve që do të mbikqyret.

Operatori ekonomik për tu vlerësuar për këtë nën-kriter duhet të paraqesë eksperiencat e secilit prej stafit kyc të propozuar.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k3} = O_{k3} \times P_{\max k3} / V_{\max k3}$$

P_{k3}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\max k3}$	Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (vlera më e lartë e objektit të ngjashëm)
$P_{\max k3}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k3}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për të plotësuar këtë kriter ofertuesit do të sjellin dokumentacionin e nevojshëm për plotësimin e kriterit të kualifikimit të parashikuar në Shtojcën 8, pika 2.3.3 dhe njekohesisht informacion shtese sipas formatit bashkelidhur (Aneks 1).

Aneksi 1 nuk zëvendëson dokumentacionin provues të kërkuar në DST, por shërben si format standard për paraqitjen dhe strukturimin e informacionit të nevojshëm për vlerësimin e eksperiencës së stafit teknik. Vlerësimi do të bazohet vetëm në informacionin e deklaruar në Aneksin 1, për atë sa ky informacion provohet me dokumentacion mbështetës të vlefshëm.

Vlerësimi i eksperiencës së stafit teknik do të bëhet për secilin pozicion më vete, në bazë të:

1. *Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës. pike 0-2*
2. *Eksperiencia në fushën përkatëse përfshin: eksperiencia në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor. pike 0-3*

Projekte të ngjashme konsiderohen ato projekte ku stafi i propozuar ka qenë i angazhuar në mbikëqyrjen e punimeve të infrastrukturës rrugore dhe/ose ndërhyrjeve urbane, me elementë teknikë të krahasueshëm me objektin e kontratës dhe në rol teknik të përshtatshëm me pozicionin e propozuar.